



PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE: PËRFSHIRJA DIXHITALE NË SHQIPËRI

Korrik 2025

Në legjislacionin shqiptar, përfshirja dixhitale nuk përkufizohet; megjithatë, aspekte të lidhura me të shfaqen në strategji të ndryshme, zakonisht përmes qasjes në internet, aftësive dixhitale, dhe reduktimit të pabarazive. Grupe të cënueshme përmenden, por nuk përcaktohen qartë, dhe politikat kryesisht fokusohen tek infrastruktura sesa tek aftësitë dhe aksesueshmëria. Sipas ekspertëve, Shqipëria po përjeton një dixhitalizim të pjesshëm, më shumë sesa një transformim të mirëfilltë dixhital, dhe që përputhet vetëm pjesërisht me standardet e BE-së. Përpjekjet mbeten të fragmentuara, të financuara në mënyrë të pamjaftueshme, dhe pa një përfshirje sistematike të shoqërisë civile dhe komuniteteve të marginalizuara.

Kutia 1: Grupe të cënueshme, të rrezikuara nga përjashtimi dixhital

Të moshuarit (aftësi jo të mira dixhitale dhe mbështetje e pamjaftueshme)

Personat me aftësi të kufizuara (platforma jo të aksesueshme dhe mungesë e teknologjive ndihmëse)

Banorët e zonave rurale (infrastrukturë e dobët dhe mundësi të kufizuara për zhvillimin e aftësive dixhitale)

Familjet me të ardhura të ulëta (mungesë akses në pajisje dhe internet)

Komunitetet rome dhe egjiptiane (ndërthurje e disa formave të diskriminimit)


Personat transgjorë (stigmatizim dhe akses i kufizuar në shërbime dixhitale)

Të rinjtë jashtë sistemit arsimor apo programeve të trajnimit (mundësi të kufizuara për përfshirje në programe për zhvillimin e aftësive dixhitale)


Gratë dhe vajzat, veçanërisht në zonat rurale (akses i kufizuar dhe kohë e pamjaftueshme për përfshirje dixhitale)

Personat e papunë (mundësi të pakta për zhvillim të aftësive dixhitale)


% e familjeve që kanë akses në internet




% e popullsisë që përdor internetin



% që përdor smartphone për të hyrë në internet



% që përdor kompjuter personal



% që përdor shërbime përmes e-qeverisjes




Figura 1: Tregues bazë të përfshirjes dixhitale, Burimet: Instat, 2023a, 2023b, 2024¹

Personat me arsim të ulët (mungesë njohurish bazë dixhitale)

Fëmijët nën kujdesin e të moshuarve (mungesë mbështetjeje për akses dhe zhvillim njohurish dixhitale)

Fermerët e vegjël (infrastrukturë e dobët, sisteme informacioni të fragmentuara)

¹ Instat. (2023a). *Income and Living Conditions in Albania*. <https://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/income-and-living-conditions-in-albania/>; Instat. (2023b). *Survey on Information and Communication Technologies (ICT) usage in Households and by Individuals in 2023*. <https://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/information-and-communication-technologies-ict-usage-in-households-and-by-individuals/publication/2023/survey-on-information-and-communication-technologies-ict-usage-in-households-and-by-individuals-in-2023/>; Instat. (2024). *Survey on Information and Communication Technologies (ICT) usage in Households and by Individuals in 2024*. <https://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/information-and-communication-technologies-ict-usage-in-households-and-by-individuals/publication/2024/survey-on-information-and-communication-technologies-ict-usage-in-households-and-by-individuals-in-2024/>

² Based on information collected from interviews and focus groups.

Sfidat kryesore

Aftësitë jo të mira dixhitale çojnë në varësi tek të tjerët, dhe kjo sjell kosto shtesë dhe rrezik për privatësinë e të dhënave.

Personat me aftësi të kufizuara dhe fermerët përballen me përjashtim dixhital për shkak të platformave të paaksesueshme, mungesës së teknologjive ndihmëse, aftësive jo të mira dixhitale, lidhjes së dobët me internetin, dhe sistemeve të fragmentuara dixhitale.

Aftësitë dixhitale janë pjesë e kurrikulës; megjithatë, infrastruktura e dobët, trajnimi joefektiv i mësuesve, dhe mungesa e burimeve në shkollë e thellojnë hendekun dixhital, sidomos për nxënësit nga familjet me të ardhura të ulëta.

Shërbimet dixhitale në fushën e shëndetësisë janë të pazhvilluara, programet pilot janë ndërprerë, dhe stafi mjekësor përdor mjete joformale për të komunikuar me pacientët, duke bërë që pacientët, sidomos në zonat e largëta, të vuajnë mungesën e aksesit në kujdesin shëndetësor.

Politikat dixhitale shpesh hartohen pa përfshirjen e komuniteteve, duke çuar në strategji që pasqyrojnë prioritetet institucionale dhe jo domosdoshmërisht nevojat lokale.

Megjithëse janë bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën dixhitale, përfshirja dixhitale nuk përbën ende prioritet. Financimet e kufizuara, fokusi i pakët tek aksesueshmëria, dhe trajnimet e pamjaftueshme janë disa nga shqetësimet. Për më tepër, qeveria vendore ka kapacitete të kufizuara.

Mungesa e transparencës rreth buxhetit që alokohet ekskluzivisht për përfshirjen dixhitale dhe vëmendja e kufizuar ndaj përvojës së përdoruesve me shërbimet dixhitale bëjnë që grupet e cenueshme të anashkalohen si në të dhëna, ashtu edhe në matjen e rezultateve të politikave.

Përdoruesit e e-Albania janë të shqetësuar pasi nuk kanë mundësi të kërkojnë ndihmë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të ankohen; personave me aftësi jo të mira dixhitale nuk u sigurohet mbështetja e nevojshme për të përdorur shërbimet dixhitale.

Rekomandimet kryesore

Qeveria duhet të krijojë një kuadër të unifikuar për përfshirjen dixhitale. Kuadri duhet të përputhet me standardet e BE-së dhe të sigurojë që përfshirja integrohet në të gjitha aspektet e transformimit dixhital.

Nismat për aftësitë dixhitale duhet të zgjerohen dhe të jenë afatgjata, duke përfshirë jo vetëm aftësitë bazë, por edhe të drejtat dixhitale, mbrojtjen e të dhënave, dhe sigurinë kibernetike. Zbatimi i tyre duhet të mbështetet nga bashkëpunimi midis institucioneve arsimore, shoqërisë civile, dhe organeve vendore.

Platforma publike si e-Albania duhet të aksesohen me më shumë lehtësi. Kjo mund të arrihet përmes udhëzimeve në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, mbështetjes së drejtpërdrejtë, videove shpjeguese, dhe përshtatjes për personat me aftësi të kufizuara.

Një model hibrid, i cili kombinon ofrimin e shërbimeve në mënyrë dixhitale dhe fizike, do të ndihmojë përdoruesit që janë të përjashtuar nga teknologjia.

Transformimi dixhital duhet të vendosë në qendër komunikimin me publikun dhe përfshirjen e komunitetit, duke siguruar transparencë mbi ndikimin, financimin, dhe ecurinë e iniciativave dixhitale, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin për shërbimet dhe të drejtat dixhitale përmes fushatave informuese.

Trajnimet për zhvillimin e aftësive dixhitale, të cilat janë të përshtatura për nevojat e komuniteteve, janë të domosdoshme për të ngushtuar hendekun dixhital dhe për të garantuar përfshirje të gjerë.

Integrimi i përfshirjes dixhitale në shëndetësi, arsim, punësim, dhe financa është parakusht për përmirësimin e aksesit në shërbime për grupet që janë të rrezikuara nga përjashtimi dixhital, si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, banorët e zonave rurale, dhe familjet me të ardhura të ulëta.

Për të hartuar politika dixhitale gjithëpërfshirëse, nevojiten të dhëna të përditësuara dhe të detajuara mbi aksesin, përdorimin, dhe aftësitë e grupeve të cenueshme, në mënyrë që të mund të planifikohet, vlerësohet, dhe të ndiqet zbatimi i politikave në kohë.

Një shembull premtues i përfshirjes dixhitale: Nisma Këndi e-Albania

Në vitin 2023, organizata e shoqërisë civile *Walk in My Shoes* vuri re se komunitetet rome dhe egjiptiane po hasnin një vështirësi: shumë prej anëtarëve të këtyre komuniteteve nuk arrinin të përdornin vetë platformën e-Albania. Për të përfituar shërbime online, ata shkonin në qendra interneti, por ajo që ndodhte ishte se harronin kredencialet për të hyrë në platformë dhe binin pre të praktikave shfrytëzuese. Në disa raste, llogaritë e tyre bllokoheshin dhe iu kërkohej pagesa prej 500 lekësh (rreth 5 euro) për t'ua rihapur. Për t'iu përgjigjur kësaj situate, organizata ndërmori nismën Këndi e-Albania, duke hapur qendra mbështetjeje në nëntë zona të ndryshme të vendit. Këto kënde, të integruara në programe lokale passhkollore dhe që funksionojnë tri herë në javë, ofrojnë ndihmë për të përdorur e-Albania. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të nxitur përdorimin e shërbimeve online, ekipi organizoi një fushatë informimi në terren, me shpërndarje fletëpalosjesh derë më derë dhe postera në hapësira të frekuentuara të komunitetit. Rezultatet kanë qenë të preksme: janë hapur mbi 600 llogari të reja në e-Albania dhe janë shkarkuar mbi 1,500 dokumente zyrtare, që nga formularët e regjistrimit në shkollë, dokumentet e banesave e pronave, aplikimet për pensione e deri tek formularët e ID-ve dhe pasaportave. Edhe pse kjo nismë synon kryesisht komunitetet rome dhe egjiptiane, rreth 30% e përfituesve vijnë nga grupe të tjera të cenueshme, duke treguar se ka një nevojë shumë më të madhe. E nisur në vitin 2023, kjo iniciativë vijon ende dhe shihet si një model që mund të zgjerohet për të ofruar shërbime dixhitale gjithëpërfshirëse në të gjithë vendin.